



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr. 982/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik G.I Srpska, dega në Partesh, paraqitur kundër Samostalna Liberalna Stranka (SLS), për shkak të parregullsive gjatë ditës së votimit të raundit të dytë gjatë zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik G.I Srpska, dega në Partesh.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 02.12.2013, nga ana e subjekti politik G. I Srpska, dega në Partesh, në të cilën pretendohet se në tri vendvotime 3603D/01R, 3603D/02R, 3603D/03R në Pasjanë, komuna e Parteshit, pas përfundimit të votimit dhe pas numërimit të fletëvotimeve, pas orës 19:00, me datë 01.12.2013, ka hyrë me dhunë një grup prej dhjetëra aktivistë të SLS-së të cilët kanë sulmuar anëtarët e G.I. Srpska dhe e kanë shkatërruar dhe thyer kutitë e votimit dhe procesverbalet, krejt kjo me qëllim të pamundësohet fitorja e kandidatit e G.I. Srpska. Sipas parashtruesit të ankesës hyrja e aktivistëve të SLS-së ka qenë pas numërimit të votave dhe pasi që është kuptuar që kandidati i SLS-së nuk ka fituar sepse ekzistojnë të dhëna tek vëzhguesit e Bashkimit Evropian lidhur me rezultatet e zgjedhjeve.

Parashtruesi i ankesës kërkon që të pranohen rezultatet e zgjedhjeve në tri vendvotime në Pasjan. Në cilësinë e provës në këtë ankesë janë shënuar dëshmitarët e mundur: Vladan Bogdanoviq, Lugomir Batary, Jozes Hartl dhe Jelena Kilibarda.

PZAP-i, e informoi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 03.12.2013, për ankesën që është bërë nga subjekti politik G.I. Srpska dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 04.12.2013, në ora 10:00.

PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga KQZ, sipas afatit të caktuar dhe ka ofruar Raportin e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve (QNR) duke specifikuar rastet dhe duke bërë përshkrimin e këtyre rasteve që gjenden në karantinë. KQZ, me vendimin e datës 02.12.2013 me nr.2032/2013, kanë miratuar rekomandimin e QNR-së, për mospërfshirjen në rezultate përfundimtare QV.3603/D në komunën e Pasjanit për Zgjedhjet Lokale të raundit të dytë për kryetar komune.

Me dt.03.12.2013 PZAP-i, nëpërmjet emailit ka kërkuar nga policia raportin për të njëjtin rast, dhe në të njëjtën datë ka pranuar përgjigjen nëpërmjet emailit nga policia ku njofton se rasti është i hapur dhe hetimet janë duke vazhduar lidhur me këtë incident.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet ankimore të palës ankuese, se në tri Vendvotimet 3603D/01R, 3603D/02R, 3603D/03R, në Pasjan, komunë e Parteshit, është dëmtuar materiali zgjedhor dhe nuk përmban shiritat e sigurisë nga aktivistë të SLS-së, dhe kërkesës së këtij subjekti që të pranohen rezultatet e zgjedhjeve, është e pabazë, për arsye se me Rregullën Zgjedhore Nr.06/2013, neni 4.1 dhe 4.2 pika c), dhe në bazë të vendimit të KQZ-së me nr. 2032/2013, shihet se materiali zgjedhor i QV 3603D, është i dëmtuar dhe nuk përmban shiritat e sigurisë, dhe është vendosur mospërfshirja në rezultatet përfundimtare të kësaj qendre të votimit që pretendohet në ankesë, PZAP-i, në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 982/2013 më datën 04.12.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala**



***Këshillë Juridik:***

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda 24 ( njëzetekatër )orë nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.